

UDHËZIM
Nr.1037/1, datë 12.4.2011

PËR VLERËSIMIN DHE MENAXHIMIN E ZHURMËS MJEDISORE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe Shteteve Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish Republikës së Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një Zone të Përbashkët Europiane të Aviacionit”,

UDHËZJOJ:

Neni 1
Objektivat

1. Qëllimi i këtij udhëzimi do të jetë të përcaktojë një qëndrim të përbashkët me qëllim për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar në një bazë prioriteti efektet e dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen, për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore. Për këtë qëllim, këto veprime do të zbatohen në mënyrë progresive:

a) Përcaktimi i ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore, përmes hartës së zhurmave, nga metodat e vlerësimit sipas këtij udhëzimi;

b) Të sigurojë që informacioni mbi zhurmën mjedisore dhe efektet e saj janë vënë në dispozicion të publikut;

c) Realizimi i planeve të veprimit, të bazuar mbi rezultatet e hartës së zhurmave, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës mjedisore kur është e nevojshme, veçanërisht kur nivelet e ekspozimit mund të shkaktojnë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe në ruajtjen e cilësisë së mjedisit nga zhurma, atje ku kjo cilësi e mjedisit mund të jetë e mirë.

2. Ky udhëzim, gjithashtu, duhet të synojë një bazë për marrjen e masave për të reduktuar zhurmën e emetuar nga burimet e mëdha, në veçanti të mjeteve dhe infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, avionëve, pajisjeve dhe makinerive të lëvizshme.

Neni 2
Qëllimi

1. Ky udhëzim zbatohet për zhurmën mjedisore, ndaj të cilës njerëzit ekspozohen në veçanti në zonat në ndërtim e sipër, në parqet publike ose zonat e tjera të qeta në një grumbullim, në fusha të qeta në vendet e hapura, afër shkollave, spitaleve dhe objekteve dhe fusha të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave.

2. Ky udhëzim nuk do të zbatohet për zhurmën e shkaktuar nga vetë personi i ekspozuar, zhurma nga aktivitetet e brendshme, nga zhurma të krijuara nga fqinjët, zhurmës në vende të punës ose zhurma brenda mjeteve të transportit ose për shkak të aktiviteteve ushtarake në zonat ushtarake.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllime të këtij udhëzimi:

a) “Zhurmë mjedisore” do të thotë tingull i jashtëm, i padëshiruar ose i dëmshëm në natyrë, i krijuar nga aktivitetet njerëzore, duke përfshirë edhe zhurmën e emetuar nga mjetet e

transportit, trafikut rrugor, trafikut hekurudhor e trafikut ajror, si dhe nga zonat e aktiviteve industriale.

b) “Efekte të dëmshme” do të thotë efekte negative në shëndetin e njeriut.

c) “Bezdi” do të thotë shkalla e zhurmës bezdisëse në vend, e përcaktuar me anë të shqyrtimeve në terren.

d) “Tregues i zhurmës” do të thotë shkalla fizike që përshkruan zhurmën mjedisore, e cila ka një raport me një efekt të dëmshëm.

e) “Vlerësim” do të thotë çdo metodë që përdoret për llogaritje, parashikim, vlerësim apo matje të vlerës së treguesit të zhurmës ose efekteve të dëmshme të lidhura me to.

f) “ L_{dpn} ” (tregues i zhurmës në ditë-pasditë-natën) nënkupton treguesin e zhurmës bezdisëse të përgjithshëm, siç përcaktohet më tej në shtojcën I.

g) “ L_{dite} ” (tregues i zhurmës ditën) nënkupton treguesin e zhurmës bezdisëse gjatë ditës, siç është përcaktuar më tej në shtojcën I.

h) “ $L_{pasdite}$ ” (tregues i zhurmës pasdite) nënkupton treguesin e zhurmës bezdisëse gjatë periudhës së pasdites, siç përcaktohet më tej në shtojcën I.

i) “ L_{nate} ” (tregues i zhurmës gjatë natës) nënkupton treguesin e zhurmës për prishjen e gjumit, siç përcaktohet më tej në shtojcën I.

j) “Raporti dozë-efekt” nënkupton marrëdhënien mes vlerës së një treguesi të zhurmës dhe efektit të dëmshëm.

k) “Grumbullim” do të thotë pjesë e territorit brenda Republikës së Shqipërisë, që ka një popullsi më të madhe se 100 000 persona dhe një dendësi të popullsisë në një masë të tillë që të mund të klasifikohet si zonë urbane, sipas legjislacionit në fuqi.

l) “Zonë e qetë në një grumbullim” do të thotë një zonë e kufizuar nga autoriteti kompetent, e cila për shembull nuk është e ekspozuar ndaj një vlere të L_{dpn} ose të një tjetër treguesi zhurme më të madh se sa një vlerë e përcaktuar nga organet kompetente, nga çdo burim zhurme.

m) “Zonë e qetë në vendet e hapura” do të thotë një zonë e kufizuar nga autoriteti kompetent, që nuk shqetësohet nga zhurmat prej trafikut, industrisë apo aktiviteve rekreative.

n) “Rrugë kryesore” do të thotë një rrugë rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare e përcaktuar nga shteti, në të cilën kalojnë më shumë se tre milionë automjete në vit.

o) “hekurudhë kryesore” do të thotë një hekurudhë e përcaktuar nga shteti, në të cilën kalojnë më shumë se 30 000 trena në vit.

p) “Aeroport kryesor” do të thotë një aeroport civil i përcaktuar nga shteti, i cili ka më shumë se 50 000 lëvizje në vit (lëvizje është një ngritje ose një ulje), duke përjashtuar lëvizjet për qëllime të trajnimit të avionëve të lehtë.

q) “Harta e zhurmave” do të thotë paraqitja e të dhënave në një situatë zhurmash ekzistuese ose të parashikuar në termat e treguesit të zhurmës, që tregon shkeljet e çdo vlere kufitare relevante në fuqi, numri i njerëzve të prekur në një zonë të caktuar, ose numri i banesave të ekspozuara ndaj vlerave të caktuara të treguesit të zhurmës në zonat e caktuara;

r) “Harta strategjike e zhurmave” do të thotë një hartë e përpiluar për vlerësimin global të ekspozimit të zhurmës në zonën e caktuar për shkak të burimeve të ndryshme të zhurmës ose për parashikimin e përgjithshëm të zhurmave në një zonë të tillë.

s) “Vlerë kufitare” nënkupton vlerën e L_{dpn} ose L_{nate} , dhe kur është e nevojshme të L_{dite} dhe $L_{pasdite}$, të përcaktuara nga autoritetet kompetente, tejkalimi i së cilës bën që autoritetet kompetente të marrin në konsideratë apo të zbatojnë masa për zbutjen e tyre; vlerat kufitare mund të jenë të ndryshme për lloje të ndryshme të zhurmës (zhurmë rrugësh, hekurudhash, trafikut ajror, zhurmat industriale etj.), mjedise të ndryshme dhe ndjeshmëri të ndryshme të popullatës ndaj zhurmës; ato mund të jenë të ndryshme për situata ekzistuese dhe për situata të reja (kur ka një ndryshim të situatës lidhur me burimin e zhurmës ose shfrytëzimin e rrethinës).

t) “Plane të veprimt” do të thotë plan i hartuar për të menaxhuar çështjet dhe efektet e zhurmës, duke përfshirë edhe zvogëlimin e zhurmës, nëse është e nevojshme.

u) “Planifikimi akustik” do të thotë kontrolli i zhurmave të ardhshme me masa të planifikuara, si për shembull planifikimin e përdorimit të tokës, sistemet inxhinierike për trafikun, planifikimin e trafikut, reduktimin e zhurmave me masa për izolimin e tingullit dhe kontrollit të zhurmës në burime.

v) “Publiku” do të thotë një ose më shumë persona fizikë apo juridikë, si dhe në përputhje me legjislacionin për shoqatat, organizatat ose grupimet.

w) Aneksat I, II, III, IV dhe V të përshkruara në këtë udhëzim, janë pjesë integrale e tij.

Neni 4

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Autoritetet kompetente do të jenë përgjegjëse për:

a) të bërë dhe, kur është e përshtatshme, për të aprovuar hartat e zhurmave dhe planet e veprimit për grumbullimet, rrugët kryesore, hekurudhat dhe aeroportet e mëdha;

b) mbledhjen e hartave të zhurmës dhe planeve të veprimit.

Neni 5

Treguesit e zhurmës dhe zbatimi i tyre

1. Autoritetet kompetente mund të aplikojnë treguesit e zhurmave L_{dpn} dhe L_{nate} të referuar në aneksin I për përgatitjen dhe rishikimin e hartës strategjike të zhurmës, në pajtim me nenin 7.

2. Mund të përdoren tregues plotësues të zhurmës për rastet e veçanta, si ato të listuara në shtojcën I (3).

3. Për planifikimin dhe caktimin e zonave të zhurmave akustike, mund të përdoren tregues të tjerë të zhurmës në vend të L_{dpn} dhe L_{nate} .

Neni 6

Metodat e vlerësimit

1. Vlerat e L_{dpn} dhe L_{nate} do të përcaktohen me anë të metodave të vlerësimit të përcaktuara në aneksin II.

2. Metodat e vlerësimit për përcaktimin e L_{dpn} dhe L_{nate} do të vendosen nga organet kompetente në pajtim me procedurën e përcaktuar në nenin 13 (2) nëpërmjet një rishikimi të shtojcës II. Derisa këto metoda të jenë përshtatur, mund të përdoren metoda të vlerësimit të përshtatura në përputhje me aneksin II dhe bazuar në metodat e përcaktuara në legjislacionin aktual. Në rast të tillë, duhet të provohet se këto metoda japin rezultate të barabarta me rezultatet e arritura me metodat e përcaktuara në paragrafin 2.2 të shtojcës II.

3. Efektet e dëmshme mund të vlerësohen me anë të marrëdhënieve dozë-efekt të referuara në aneksin III.

Neni 7

Hartat strategjike të zhurmës

1. Brenda 5 viteve nga data e miratimit të këtij udhëzimi duhet të jenë përgatitur hartat strategjike të zhurmës, duke paraqitur situatën në vitin e kaluar kalendarik dhe, kur është e nevojshme, të jenë miratuar nga autoritetet kompetente, për të gjitha bashkësitë e popullsisë me më shumë se 250 000 banorë dhe për të gjitha rrugët e mëdha, të cilat kanë më shumë se gjashtë milion automjete në vit; hekurudhat e mëdha, të cilat kanë kalime të më shumë se 60 000 trenave në vit dhe aeroportet e mëdha në territorin e tyre.

2. Brenda 10 viteve nga data e miratimit të këtij udhëzimi dhe, më pas çdo pesë vjet, duhet të përgatiten hartat e zhurmës strategjike, duke paraqitur situatën në vitin e kaluar

kalendarik dhe, kur është e nevojshme, të jenë miratuar nga autoritetet kompetente për të gjitha grumbullimet dhe për të gjitha rrugët kryesore dhe hekurudhat e mëdha në territorin e tyre.

3. Hartat strategjike të zhurmës duhet të përmbushin kërkesat minimale të përshkruara në aneksin IV.

4. Autoritetet kompetente do të bashkëpunojnë me autoritetet fqinje për hartimin e hartave të zhurmës strategjike pranë kufijve.

5. Hartat strategjike të zhurmës duhet të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme, të korrigjohen, së paku çdo pesë vjet pas datës së përgatitjes së tyre.

Neni 8

Planet e veprimit

1. Plane veprimi për menaxhimin e çështjeve të zhurmës dhe efekteve të saj, duke përfshirë edhe zvogëlimin e zhurmës, nëse është e nevojshme, do të hartohen për:

A. Vendet pranë rrugëve kryesore, të cilat kanë më shumë se gjashtë milionë automjete në vit, hekurudhat e rëndësishme, të cilat kanë udhëtime të më shumë se 60 000 trenave në vit, si dhe aeroportet kryesore;

B. Bashkësitë e popullsisë me më shumë se 250 000 banorë. Plane të tilla duhet të synojnë mbrojtjen e zonave të qeta kundër një rritjeje të zhurmave.

Masat në lidhje me planet duhet të adresojnë prioritetet, e sidomos ato të cilat mund të identifikohen nga tejkalimi i çdo vlere kufitare përkatëse ose në bazë të kritereve të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe zbatohen në mënyrë të veçantë në zonat më të rëndësishme, të themeluara sipas hartës së zhurmave strategjike.

2. Duhet përpiluar plane veprimi, veçanërisht për të adresuar prioritetet që mund të identifikohen nga tejkalimi i çdo vlere kufitare përkatëse ose në bazë të kritereve të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për bashkësitë e popullsisë dhe për rrugët dhe hekurudhat kryesore.

3. Planet e veprimit do të plotësojnë kërkesat minimale të shtojcës V.

4. Planet e veprimit do të shqyrtohen dhe rishikohen, nëse është e nevojshme, kur ndodh një zhvillim i madh që ndikon në situatën ekzistuese të zhurmës dhe të paktën çdo 5 vjet pas datës së miratimit të tyre.

5. Planet mjedisore të mjedisit janë publike dhe i vihen në dispozicion publikut sipas kërkesës, për t'u konsultuar me to.

Neni 9

Informacion për publikun

1. Publiku ka të drejtë të informohet për hartat strategjike të zhurmës dhe, kur është e nevojshme, hartat strategjike të zhurmës të adoptuara, si dhe planet e veprimit që janë hartuar për çështjen mjedisore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Ky informacion duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i arritshëm. Autoritetet kompetente duhet të përpilojnë një përmbledhje që paraqet çështjet më të rëndësishme.

Neni 10

Aspekte që mbulohen nga plani i veprimit

1. Planet e veprimit për zhurmën mjedisore duhet të përmbajnë masa për implementimin e strategjive për aspekte të tilla si:

A. Qëllimet afatgjata dhe afatmesme për reduktimin e numrit të personave të dëmtuar nga zhurmat e mjedisit, veçanërisht duke marrë parasysh zonat përkatëse;

B. Masa të tjera për uljen e zhurmës mjedisore të emetuara nga burime të veçanta, nga pajisje të veçanta në natyrë, mjete dhe infrastrukturës së transportit dhe të kategorive të caktuara të aktiviteteve industriale, duke u mbështetur mbi këto masa të zbatuara tashmë ose që janë në diskutim për miratim;

C. Mbrojtjen e zonave të qeta në vendet e hapura.

2. Pas përpilimit të hartave të zhurmës strategjike, do të rishikohet:

- mundësia për një lartësi matje 1,5 metër në shtojcën I, paragrafi 1, në lidhje me zonat ku ka shtëpi njëkatëshe,

- kufiri i ulët për numrin e parashikuar të njerëzve të ekspozuar në grupe të ndryshme të L_{dpn} dhe L_{nate} në aneksin VI.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Sokol Olldashi

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Fatmir Mediu